



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1680, datë 08.09.2011**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1598, datë 03.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 08.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1598, datë 03.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shpresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1598, datë 03.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Shkresa e Unifi Holdings. Inc. Dega Shqipëri, datë 05.06.2011, “*Dërgohen pretendimet e Unifi Holdings. Inc. Dega Shqipëri në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1598, datë 03.05.2011, njoftuar më date 30.05.2011*”, (AKEP: nr. 632/4 prot, datë 09.06.2011)”;
3. Korrespondenca shkresore midis palëve,
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R Ë N:

- I.** Unifi Holdings. Inc. Dega Shqipëri, me shkresën e datës 05.06.2011, “*Dërgohen pretendimet e Unifi Holdings. Inc. Dega Shqipëri në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1598, datë 03.05.2011, njoftuar më date 30.05.2011*”, (AKEP: nr. 632/4 prot, datë 09.06.2011)”, (këtu e mëposhtë Unifi) ngre pretendimet si më poshtë:
1. Unifi, duke i’u referuar bazës ligjore si më poshtë vijon:
    - Neni 42 dhe 47 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
    - Neneve 3, 4.3, 4.5, 5.4, 6.3, dhe 6.5 të Vendimit nr. 1211, date 31.03.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Al me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, i ndryshuar;
    - Neneve 4.1, 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, 5.1, 5.6, nenit 6 dhe 7 të Rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendimin nr. 1300, datë 14.06.2010 të KD të AKEP, i ndryshuar;

Shpjegon se, Vodafone Al ka detyrimin ligjor për t'i ofruar Unifi interkoneksion në bazë të ofertës referencë të interkoneksionit të miratuar nga AKEP me Vendimin nr. 1468, date 23.12.2010 “Për miratimin e ofertës reference të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”, ndryshuar me Vendim nr. 1559, date 20.04.2011;

2. Unifi thekson se, ofron rrjetin shërbimet e veta publike telefonike zanore drejt dhe nga Shqipëria duke përdorur teknologjinë “VOIP”, këto shërbime ofrohen me shumicë midis operatorëve të ndryshme të shërbimeve zanore, duke përdorur si mjet kryesor transmetimi rrjetin publik internet;
  3. Unifi e ofron rrjetin dhe shërbimet e veta nëpërmjet dhe duke shfrytëzuar kapacitetin e internetit të nevojshëm për të bartur trafikun e tij dhe të marrë me qira nga Unifi për këtë qëllim. Këto kapacitete interneti përbëjnë edhe rrjetin e komunikimeve elektronike të Unifi në kuptim të Ligjit nr. 9918, rrjet i cili shtrihet nga Shqipëria deri në pikën kryesore të interkoneksionit të aksesit dhe centralin e Unifit në New York , SHBA;
  4. Për sa më sipër Unifi thekson se, nuk ka asnjë dispozitë në legjislacionin shqiptar të komunikimeve elektronike që të detyrojë operatorët e rrjeteve/dhe ose shërbimeve elektronike që të mbajnë cilësinë e pronarit të rrjeteve të komunikimeve elektronike që ofron dhe përdoret nga operatorë për ofrimin e shërbimeve të tyre, por çdo operatorë ka detyrimin që të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike pavarësisht nga titulli ligjor që ky operator mban mbi këtë rrjet. Në fakt është mese e zakonshme në industrinë e telekomunikacioneve që operatorët, në vend që të ndërtojnë vet një rrjet, të përdorin pajisje e rrjete të zotëruara nga operatorë të tjerë.
  5. Unifi argumenton se, në kundërshtim me pretendimin e Vodafone Al, rezulton e provuar se Unifi:
    - Është një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike e pikërisht të rrjetit të internetit I cili është marrë me qira nga të tretë dhe,
    - Ofron shërbime elektronike sipas njoftimit të AKEP dhe konfirmimit pëtkatës të tij;
  6. Për gjithë sa më sipër, Unifi i kërkon AKEP të Vendosë:
    - Zgjidhejn e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings. Inc. Dega Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a
    - Të urdhërojë Vodafone Albania sh.a të nënshkruaj marrëveshje interkoneksioni me Unifi Holdings INC Dega Shqipëri në përputhje me Vendimin nr. 1211, date 31.03.2011 të KD të AKEP, i ndryshuar, Brenda 30 ditëve nga data e nxjerrjes së Urdhërit të AKEP për këtë qëllim;
- II.** Vodafone AL, me shkresën nr. CEO/028/E.Xh. datë 21.03.2011 (AKEP:nr. 124/9 prot, datë 21.03.2011) “*Parashtrimet Vodafone Albania mbi ankesen e Unifit Holdings të datës 16.02.2011*”, sqaron se:
- Unifi Communications Inc, është person juridik i regjistruar dhe themeluar në bazë të legjislacionit të shtetit Delaware në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili ka kërkuar të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me Vodafone Albania;

- Vodafone AL konsideron se Unifi Communications nuk është një operator Shqipëtar dhe Vodafone AL nuk ka një detyrim rregullator që të lidh marrëveshje interkoneksioni me të;
- Vodafone AL thekson se, ka liri të plotë tregtare që të negociojë të lidhë ose jo marrëveshje ndërkombëtare për shkëmbimin e trafikut ndërkombëtar me shoqërit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për pasojë pretendimet e Unifi Holdings se refuzimi i Vodafone AL për të lidhur marrëveshje me Unifi Communications është i pa bazuar në ligj;
- Vodafone AL, në lidhje me kërkesën e Unifi Holdings për të lidhur marrëveshje interkoneksioni kombëtare, thekson se gjatë takimit me përfaqësues të Unifi Holdings është sqaruar se në zbatim të nenit 5.1 dhe 5.3 e drejta e interkoneksionit në Shqipëri i përket vetëm operatorëve që operojnë rrjet publik telefonik dhe ofrojnë shërbime telefonike të disponueshme për publikun në tregun shqiptar;
- Gjithashtu Vodafone AL konsideron se, me qënë se Unifi Holdings nuk ofron një rrjet të komunikimeve elektronike në Shqipëri, nuk ka se si të fitojë të drejtën e interkoneksionit kombëtar në bazë të kuadrit lgjor dhe rregullator Shqiptar;
- Vodafone AL, në lidhje me komunikimin e datës 12.01.2011 me email midis Unifit dhe Vodafone AL, sqaron se komunikimi ka të bëjë me intrekoneksionin ndërkombëtar dhe jo atë kombëtar, dhe se në thelb teksti i emailit shpjegon se Vodafone AL në kontekstin e interkoneksionit ndërkombëtar preferon që të lidhë marrëveshje vetëm me operatorë ndërkombëtar të përgjedhur dhe miratuar nga Grupi Vodafone, pra nuk ka liri veprimi për Vodafone AL që të përzgjedh se me cilin operator ndërkombëtar do të lidhë këto marrëveshje;
- Së fundmi Vodafone Al kërkon që AKEP të rrëzojë kërkesën e Unifi Holdings për interkoneksion kombëtar duke qënë se operatori në fjalë nuk operon me rrjet të komunikimeve elektronike dhe nuk ofron shërbime të telefonisë publike sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses Interkoneksionit,
- si dhe
- Të mos marrë parasysh kërkesën për lidhje interkoneksioni për operatorin Unifi Communications duke qënë se është person juridik i huaj dhe i peregjistruar në Republikën e Shqipërisë në bazë të legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe pa autorizim përkatës nga AKEP sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike;

### III. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

Sipërmarrësi Unifi Holdings Inc. Dega Shqiperi rezulton i rregjistruar në rregjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjet dhe shërbime të komunikimeve elektronike me dt. 13.01.2010, sipas njoftimit të tij nr. 91 prot, datë 11.01.2010.

Në njoftimin e tij ky sipërmarrës ka paraqitur ofrimin e rrjetit të qëndrueshëm (fiks) për tu ofruar për publikun në pjesën e parë të vitit 2011, ndërkohe që ka njoftuar shërbimin telefonik fik, shërbimin e transmetimit të të dhënave, shërbimin e internetit dhe shërbimin e linjave me qira për tu ofruar në pjesën e dytë të vitit 2011.

Më dt.22.02.2011 Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri ka depozituar kërkesë për ndërmjetësim të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me Vodafone Al, por AKEP pasi u njoh me këtë kërkesë, ka konstatuar parregullsi në paraqitjen e saj dhe i ka kërkuar Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri me shkresën 124/6, datë 2.03.2011 të rregullojë formën e paraqitjes së kërkesës sipas përcaktimeve të rregullores për procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri me dt. 29.03.2011, me shkresën nr. 526 (AKEP) prot, ka njoftuar në AKEP ndryshimin e datave të fillimit të ofrimit të rrjetit dhe shërbimeve si dhe ka njoftuar shtimin e një shërbimi të ri si bartës kombëtar dhe ndërkombëtar të thirrjeve telefonike.

Në përgjigje të kërkesës së AKEP me dt.12.04.2011 Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri ka depozituar kërkesë ankimore në AKEP për zgjidhje mosmarrëveshjeje interkoneksioni me Vodafone Al sh.a, bazuar në kërkesat e rregullores së procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. **Nga data e njoftimit të përditësuar të UNIF-it (29.03.2011) nga ku lind dhe e drejta e tij për të kërkuar Interkoneksion, deri më dt. 12.04.2011 (paraqitja e ankimit) vërehet se kanë kaluar 14 ditë, ndërkohë përcaktimet e nenit 50 të Ligj nr. 9918 parashikojnë se nëse sipërmarrësit nuk arrijnë, që brenda 45 diteve nga data e marrjes së kërkesës për akses dhe interkoneksion, të lidhin marrëveshjen e interkoneksionit, secila prej tyre mund të paraqesë ankese në AKEP".** (Pra, sipas të dhënave të rregjistrit të sipërmarrësve të cilët ofrojnë rrjet dhe shërbime, konstatojmë se Unifi-it i lind e drejta për të ofruar shërbimet e sipërcituara **me dt. 29.03.2011** ndërsa kerkesen paraprake ankimore e ka paraqitur përpara se të ishin përditësuar ndryshimet e vetkërkuara prej tij në rregjistrë, prej të cilave afroheshin afatet e ofrimit të shërbimeve perkundrejt afateve të mëparshme të kerkuara dhe njoftuara, ( pjesa e dytë e vitit 2011).

Sa më sipër, konkretisht Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri, shërbimin telefonik fik, shërbimin e transmetimit të të dhënave, shërbimin e internetit, shërbimin e linjave me qira dhe shërbimi i ri si bartës kombëtar dhe ndërkombëtar të thirrjeve telefonike, i ka njoftuar për tu ofruar duke filluar nga data 29.03.2011.

Ofrimi i rrjetit të qëndrueshem (fiks) është njoftuar të kryhet në dy faza, ku faza e parë është njoftuar data (31.12.2011), dhe faza e dytë si data ( 1.03.2012).

Si rezultat, negociatat për akses dhe interkoneksion të Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri me sipërmarrësin me FNT Vodafone.al sh.a duhej të kishin rifilluar pas datës 29.03.2011 të njoftimit të përditësuar, prej se cilës arsyetohet kërkesa për interkoneksion bazuar në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, në këtë menyre refuzimi i Vodafone Al për mos dhënie të interkoneksionit Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri përpara kësaj date është i arsyetuar dhe qëndron, për sa kohe që Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri kishte njoftuar vet në AKEP fillimin e shërbimeve në pjesën e dytë të vitit 2011, praktikisht muaji Korrik e në vazhdim të vitit 2011,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

### **V E N D O S:**

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1598, datë 03.05.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a;
2. AKEP sugjeron që palët të rifillojnë negociatat për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit sipas njoftimit të përditësuar të UNIFI Holdings Inc Dega Shqipëri për rrjetet dhe shërbimet (me dt. 29.03.2011);
3. Të njoftohen palët e interesuara Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Vodafone Albania sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**